| | | Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes. | 5 pikë | 0-1 | 2-3 | 4 | 5 | |
| | | Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve. | 5 pikë | 0-1 | 2-3 | 4 | 5 | |
| 5 | **Përdorimi i mjeteve (8 pikë)** | Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore | 4 pikë | 0-1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve. | 4 pikë | 0-1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | **Vlerësimi i përgjithshëm** | **70 pikë gjithsej** | Pikët e fituara nga mësuesi _____ | | | | |

Mësuesi kandidat _____ Drejtuesi i shkollës _____ Drejtuesi i rrjetit profesional Përfaqësuesi i ZVAP-se _____

SHTOJCA 2

**Formati për vlerësimin e portofolit të kualifikimit të punonjësve arsimorë në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë[1]**

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

| | | |
|---|---|---|
| a | Plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup klasash, organizuar nga mësuesi përkatës të realizuar gjatë vitit të kualifikimit të shoqëruar me realizimin e aktivitetit me foto.<br>1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit dhe përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit 1 pikë<br>2. Realizimit i aktivitetit dhe arritjet e tij 1 pikë<br>3. Foto origjinale nga aktiviteti 1 pikë | 0-3 pikë |
| b | Një planifikim të një mësimi model (ditar) duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin sipas kurrikulës me kompetenca;.<br>1. Përcaktimi i rezultateve të të nxënit sipas përmbajtjes së temës/temave mësimore 1 pikë<br>2. Përshkrimi i teknikave të mësimdhënies dhe vlerësimit të arritjeve të rezultateve të të nxënit 2 pikë<br>3. Përshkrimi i niveleve të arritjes 1 pikë | 0-4 pikë |
| c | Një test/detyrë përmbledhëse për një periudhë të caktuar, sipas profilit përkatës të realizuar gjatë vitit të kualifikimit të shoqëruar me rezultatet e arritura në një klasë të caktuar.<br>1. Tipet e ushtrimeve/ kërkesave. Struktura e testit/detyrës sipas niveleve. 1 pikë<br>2. Saktësia e pikëve për çdo tip ushtrimi/kërkesë. Konvertimi i pikëve në nota 1 pikë<br>3. Analiza origjinale e rezultateve të arritura në një klasë të caktuar. 2 pikë | 0-4 pikë |
| ç | Një plan të një projekti kurrikular të zhvilluar nga nxënësit e një klase të caktuar, të shoqëruar me realizimin e tij me foto.<br>1. Përputhshmëria e rezultateve të të nxënit me temën e projektit 1 pikë<br>2. Veprimtaritë kryesore të përfshira në projekt 1 pikë<br>3. Realizimi i tij i shoqëruar me foto 2 pikë | 0-4 pikë |
| d | Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja) :<br>1) Gjuhë e huaj e mbrojtur në lAL-të publike 3 pikë<br>2) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A1 2 pikë<br>3) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A2 3 pikë<br>4) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 4 pikë<br>5) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 5 pikë<br>6) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C1 6 pikë<br>7) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C2 7 pikë<br>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë dhe janë brenda fatit të vlefshmërisë, sipas legjislacionit përkatës.<br>Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit.<br>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi. | 0-7 pikë |
| e | Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60-120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.<br>Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit.<br>1. Diploma me 60-90 kredite 6 pikë<br>2. Diploma me 120 kredite 7 pikë<br>3. Doktoratë 8 pikë | 0-8 pikë |

[1] Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt s'kualifikohet. Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 4 pikë

**SHTOJCA 3**
**Formati për vlerësimin e portofolit të kualifikimit të punonjësve arsimorë në arsimin parashkollor**[2]

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

| | | |
|---|---|---|
| a | Plani i një aktiviteti të zhvilluar në bashkëpunim me prindërit<br>1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit 1 pikë<br>2. Përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit 1 pikë<br>3. Prezantimi i planit 1 pikë | 0–3 pikë |
| b | Planifikimi ditor (PD)<br>1. Lidhja e rezultateve të të nxënit me temën ditore 1 pikë<br>2. Zbatimi i kërkesave të formatit të planifikimit sipas kurrikulës së re 1 pikë<br>3. Veprimtaritë dhe metodat aktive të të mësuarit të planifikuara nga mësuesi (të shtjelluara) 1 pikë<br>4. Realizimi i planifikimit ditor me foto 1 pikë | 0–4 pikë |
| c | Planifikimi dhe zhvillimi i një teme mujore ose i projektit sipas metodologjisë me të cilën punon kopshti.<br>1. Struktura e planifikimit mujor/ Projektit sipas formatit të kurrikulës së re 1 pikë<br>2. Lidhja e rezultateve të të nxënit me trajtimin e koncepteve lëndore 1 pikë<br>3. Planet javore me aktivitetet e planifikuara 2 pikë | 0–4 pikë |
| ç | Punime të fëmijëve (mundësisht të lidhura me rubrikën c)<br>1. Përshtatja e punimeve me grup-moshën e fëmijëve 1 pikë<br>2. Larmia e punimeve të lidhura me konceptet lëndore dhe veprimtari të lira të zhvilluara në kopsht 1 pikë<br>3. Shembuj produktesh mujore të realizuara në kuadrin e një projekti, të shoqëruara me foto 2 pikë | 0–4 pikë |
| e | Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja):<br>1. Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike 3 pikë<br>2. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A1 2 pikë<br>3. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A2 3 pikë<br>4. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 4 pikë<br>5. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 5 pikë<br>6. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C1 6 pikë<br>7. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C2 7 pikë<br>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti, kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës.<br>Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit.<br>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi. | 0–7 pikë |
| f | Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.<br>Kjo lloj diplomë nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit.<br>1. Diploma me 60-90 kredite 6 pikë<br>2. Diploma me 120 kredite 7 pikë<br>3. Doktoratë 8 pikë | 0–8 pikë |

[2] Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt s'kualifikohet. Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 4 pikë

**UDHËZIM**
**Nr. 4, datë 10.2.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË VLEFSHMËRISË SË CERTIFIKATËS SË SIGURISË PËR MJETET LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË ARGËTIMIT DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NJOHJEN E SHOQËRIVE TË HUAJA KLASIFIKUESE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 127/2020, "Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i afateve të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, si dhe përcaktimi i kritereve standardeve që duhet të plotësohen nga shoqëritë e huaja klasifikuese me qëllim njohjen e tyre nga shoqëria klasifikuese e njohur nga Administrata Detare Shqiptare.

Neni 2
**Fusha e zbatimit**

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 kw ose 40.8 kf dhe tonazh nën 500 gt, që mbajnë flamurin shqiptar ose përdorin hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, Kapitenerive të Porteve, Policisë Kufitare, Doganës dhe organeve të tjera shtetërore të parashikuara me ligj.

Neni 3
**Përkufizime**

1. **"Administrata Detare"** – është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë, sipas ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, "Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë.

2. **"Drejtoria e Përgjithshme Detare**" – është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë, në varësi të ministrit përgjegjës për transportin detar .

3. **"Shoqëri klasifikuese shqiptare"** – shoqëria klasifikuese Shqiptare e krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë dhe që njihet nga Administrata Detare Shqiptare.

4. **"Certifikatë sigurie apo të klasit"** – është dokumenti i lëshuar nga shoqëria klasifikuese, e krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

5. **"Shoqëri klasifikuese e huaj**" – shoqëri klasifikuese e njohur nga administrata detare e vendit të origjinës.

6. **"Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim"** – janë mjetet sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me tonazh nën 500 gt, që kanë një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve të marrë së bashku më të lartë se 30 kw ose 40.8 kf, të klasifikuara si të tilla nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera, që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi.

KREU II
SHOQËRITË KLASIFIKUESE DHE CERTIFIKATA E SIGURISË

Neni 4
**Shoqëritë klasifikuese të huaja**

1. Shoqëria klasifikuese shqiptare e njohur nga administrata detare lëshon certifikatat respektive për mjetet turistike dhe të argëtimit të certifikuara nga një shoqëri klasifikuese e huaj e njohur prej saj.

2. Një shoqëri klasifikuese e huaj për t'u njohur nga shoqëria klasifikuese shqiptare duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në aneksin I, të këtij

udhëzimi si dhe duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë klasifikuese shqiptare.

3. Shoqëria klasifikuese shqiptare vë në dijeni Administratën Detare Shqiptare për marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me shoqëritë klasifikuese të huaja brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes.

Neni 5
**Certifikata e Sigurisë**

1. Të gjitha mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit duhet të jenë të pajisura me certifikatë sigurie.

2. Pas kryerjes së kontrollit teknik lëshohet certifikata e sigurisë për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit me afat 1-vjeçar.

3. Për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, certifikata e sigurisë do të lëshohet nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare ose do të konvertohet ajo e lëshuar nga shoqëritë e huaja të njohura prej saj, mbas kryerjes së kontrollit teknik të mjetit sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 6
**Dispozita e fundit**

Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Administrata Detare Shqiptare, shoqëria klasifikuese shqiptare dhe shoqëritë klasifikuese të huaja.

Neni 7
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
**Belinda Balluku**

ANEKS I
KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË SHOQËRI KLASIFIKUESE E HUAJ PËR T'U NJOHUR NGA SHOQËRIA KLASIFIKUESE E NJOHUR NGA ADMINISTRATA DETARE SHQIPTARE

1. Shoqëria e huaj duhet të jetë e njohur nga një administratë detare e vendit të origjinës;

2. Shoqëria e huaj klasifikuese duhet të ketë seli pranë zyrës ku ndodhet regjistri i mjeteve lundruese shqiptare sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë;

3. Të vërtetojë se ka funksionuar si një shoqëri klasifikuese për certifikimin e mjeteve lundruese për lundrime ndërkombëtare për të paktën 10 vjet sipas rregulla të veta klasore;

4. Të ketë një tonazh total të klasifikuar prej të paktën 20 mijë tonë bruto;

5. Të ketë burime njerëzore të mjaftueshme për funksionim e saj;

6. Të disponojë ambiente zyrash të mjaftueshme me qëllim garantimin e ruajtjes së vazhdueshmërisë së procedurave menaxheriale dhe administrative;

7. Të jetë e certifikuar me një sistem të brendshëm cilësie ISO 9001 ose një standard cilësie ekuivalente;

8. Të mos ketë konflikt interesi me pronarët e mjeteve lundruese, ndërtuesve të mjeteve lundruese ose të tjerëve të angazhuar komercialisht në prodhimin, pajisjen, riparimin ose funksionimin e mjeteve lundruese;

9. Të mos përfshihen në asnjë aktivitet që mund të rezultojë në konflikt interesi.

**URDHËR**
**Nr. 13, datë 16.1.2023**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET GJYQËSORE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", nenet e 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë

30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit apo personave që do të përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 30, datë 15.2.2022, "Për delegim kompetencash", pika "a" e urdhrit të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 30, datë 15.2.2022, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
**Olta Xhaçka**

**URDHËR**
**Nr. 14, datë 16.1.2023**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", nenet e 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr. 162/2020, "Për prokurimin Publik", VKM nr. 870, datë 14.12.2021, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të autoritetit kontraktor, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore të institucionit.

2. Për nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe jashtë vendit.

3. Nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 30, datë 15.2.2022, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
**Olta Xhaçka**

**URDHËR**
**Nr. 40, datë 7.2.2023**

**PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 7.3.2003, "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra, të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 18.1.2023, "Për një ndryshim të vendimit nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit'",

URDHËROJ

1. Znj. Zana Çela emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.
2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për znj. Çela fillojnë më datë 8.2.2023.
3. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
**Mirela Kumbaro Furxhi**

**URDHËR**
**Nr. 88, datë 9.2.2023**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z.Endrit Musaj, drejtor i inspektimit dhe trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 13.2.2023 deri më datë 16.2.2023.
3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i inspektimit dhe trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i inspektimit dhe trajnimeve, z.Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Ardit Bido**

**VENDIM**
**Nr. 46, datë 10.2.2023**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM", PARTIA PËR DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET (PDIU) QARKU VLORË, Z. GËZIM NURI ADEMAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për

përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"', pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 151/3 prot., datë 31.1.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Fation Sulo Veizaj i propozuar nga Partia Demokratike i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, propozuar nga koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim".

Koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 415, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim" për zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 4 (katër) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 415, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 5 (pesë), z. Gëzim Nuri Ademaj i cili i përket Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), pjesë e koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim".

Me shkresën nr. 521/1 prot., datë 3.2.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumemërore të koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, z. Gëzim Nuri Ademaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Gëzim Nuri Ademaj, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 7 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Gëzim Nuri Ademaj, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III "TË DHËNA MBI GJËNDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT".

1. Pyetjes 5. "*A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?* subjekti vetëdeklarues është përgjigjur " Po", duke deklaruar se:

"Është caktuar masa e detyrimit për tu paraqitur në policinë gjyqësore". Po kështu ka deklaruar se masa shtrënguese është revokuar. Në po këtë rubrikë ka deklaruar se në vitin 2005, Gjykata e Apelit Vlorë e ka shpallur të pafajshëm, për veprën penale të cilën nuk e ka deklaruar në formular.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit

konstatoj se, të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Gëzim Nuri Ademaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 683 prot., datë 7.2.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 682 prot., datë 7.2.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Gëzim Nuri Ademaj, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar informacion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për verifikimin e përbërësve të gjendjes civile për kandidatin për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Gëzim Nuri Ademaj, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Gëzim Nuri Ademaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Gëzim Nuri Ademaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Fation Sulo Veizaj, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) në zonën zgjedhore, Vlorë, i renditur me numër rendor 05 (pesë), z. Gëzim Nuri Ademaj.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, z. Gëzim Nuri Ademaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
**Ilirjan Celibashi**

**KËRKESË**
**Nr. 63/5, datë 6.2.2023**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i nënkalimit hekurudhor në kryqëzimin e rrugës nacionale Elbasan–Librazhd me rrugën 'Borodin Mitarja' dhe 'Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ, ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezave publike'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit të pasuritë së llojit "Arë", e cila është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9,303,354 (nëntë milion e treqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Egra Ibrahimi**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI 'RRUGA E RE E VARREZAVE ELBASAN DHE NDËRTIMI I NËNKALIMIT HEKURUDHOR NË KRYQËZIMIN E RRUGËS NACIONALE ELBASAN–LIBRAZHD ME RRUGËN 'BORODIN MITARJA' DHE 'RIKONSTRUKSION DHE NDËRHYRJE NË LINJËN KUZ, NDËRTIMI I SHESHIT TË PARKIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE"'

| NR. | PRONARI | | | TË DHËNA HIPOTEKORE | | | | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | | | | | | | | | SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | "ARË" | | | "TRUALL" | | | "NDËRTESË" | | | | | | |
| | EMRI | ATËSIA | MBIEMRI | Fshati ose Qyteti | Zona Kadastrale | Nr. pasurisë | Lloji I pasurisë | Sipërfaqja Totale | "Arë" (m2) | "Truall" (m2) | "Ndërtesë" (m2) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Vlera e kulturë bujqësore (lekë) | Vlera e drufrutorëve (lekë) | VLERA TOTALE (lekë) | |
| | A | B | C | Ç | D | E | F | G | H | I | J | K | L | M | N | O | P | Q | R | S | T | U | V | X | Y | Z |
| 1 | LINDITA<br>JONAID<br>HATIXHE<br>AIDA<br>GAZMEND<br>YMER<br>SOKOL<br>IRMA<br>ADILE<br>ZVJETLANA<br>ZHULJETA<br>HAKI<br>EDMONDA<br>ILIRJAN | IBRAHIM<br>ABDYL<br>ADEM<br>ADEM<br>ADEM<br>KADRI<br>KADRI<br>NAIM<br>NAIM<br>ALI<br>ALI<br>ALI<br>ALI<br>ALI | MYZYRI<br>MYZYRI<br>ZENELHOXHA<br>KACOLLJA<br>ZENELHOXHA<br>MYZYRI<br>MYZYRI<br>HAXHIHYSENI<br>CELIRAMA<br>GARUNJA<br>ZHIKA<br>KOTHERJA<br>PEPA<br>KOTHERJA | ELBASAN | 8522 | 18/24 | ARË | 13200 | 13200 | 0 | 0 | | | 9722 | 222 | 2158284 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2158284 | Nuk ka |
| 2 | OSMAN | HAXHI | FEJZO | ELBASAN | 8522 | 18/4 | ARË | 8000 | 8000 | 0 | 0 | 9 | 134 | 4938 | 222 | 1096236 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1096236 | Nuk ka |
| 3 | XHAFERR<br>RUZHDIE<br>ZYBA | MUSTAFA | KARADAKU<br>PEZA<br>OSMANAJ | ELBASAN | 8522 | 18/2 | ARË | 1200 | 1200 | 0 | 0 | 9 | 135 | 155 | 222 | 34410 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 34410 | Nuk ka |
| 4 | ABDYL | IBRAHIM | QATIPI | ELBASAN | 8522 | 18/1 | ARË | 6000 | 6000 | | | 9 | 130 | 2910 | 222 | 646020 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 646020 | Nuk ka |
| 5 | EMIN | | KACADEI | ELBASAN | 8522 | 18/25 | ARË | 8000 | 8000 | 0 | 0 | 9 | 149 | 8000 | 222 | 1776000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1776000 | Nuk ka |
| 6 | ABDURRAMAN | MEHMET | BELULI | ELBASAN | 8522 | 18/23 | ARË | 8000 | 8000 | 0 | 0 | 9 | 146 | 8000 | 222 | 1776000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1776000 | Nuk ka |
| 7 | NADA<br>AGRON<br>EDUART<br>MAMICA<br>REZARTA<br>TAJAR | ALI<br>SKENDER<br>SKENDER<br>SOKOL<br>SOKOL<br>ALI | SKIKULI<br>HAXHIHYSENI<br>HAXHIHYSENI<br>GRABOCKA<br>GRABOCKA<br>QERFOZI | ELBASAN | 8522 | 18/157 | ARË | 8182 | 8182 | 0 | 0 | 33 | 232 | 8182 | 222 | 1816404 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1816404 | Nuk ka |
| 8 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/307 | ARË | | | | | | | 198 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 9 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/303 | ARË | | | | | | | 4066 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 10 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/304 | ARË | | | | | | | 431 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 11 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/305 | ARË | | | | | | | 353 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 12 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/28 | ARË | | | | | | | 1294 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 13 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/301 | ARË | | | | | | | 5171 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| 14 | SHTET | | | ELBASAN | 8522 | 18/306 | ARË | | | | | | | 20 | | | | | | | | | | | | Nuk ka Kartelë. Vetëm Fragment Harte (ASHK Elbasan) |
| | | | | | | | SHUMA | | | | | | | | | | | | | | | | | | 9303354 | |

**KËRKESË**
**Nr. 187/3, datë 13.2.2023**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesë, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i rrugës 'Tasi Dëma', Fier'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni bashkëpronarët e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "truall".

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3 052 210 (tre milionë e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Egra Ibrahimi**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'TASI DËMA', FIER"

| Nr. | EMËR ATËSIA MBIEMËR | Zona Kad. | Nr. pas. | Sip. e truallit (m²) gjithsej | Sip. e truallit që shpronësohet (m²) | Çmimi i truallit (l/m²) | Vlera e truallit (lek) | VLERA totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lek) | KONFIRMIMI ASHK FIER |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Artan Isufaj, Rubin Isufaj, Sokol Isufaj, Kimete Isufaj | 8531 | 13/484 | 819 | 245 | 12458 | 3,052,210 | 3,052,210 | ME CERTIFIKATË PRONËSIE |
| SHUMA TOTALE | | | | | | | | 3,052,210 | |

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 616, datë 13.9.2022, vendosi shpalljen të zhdukur, më datë 31.7.1997, të shtetasit Naim Shabani, i biri i Murat dhe Zejnebe, i datëlindjes 15.3.1952, lindur në Tragjas dhe banues në Orikum, Vlorë.

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 848, datë 30.11.2022 vendosi shpalljen të vdekur, më datë 20.2.2002 (mbytur në det për kalim kufiri me skaf), të shtetasit Muharem Ruçaj, i biri i Dajko dhe Hatike, i datëlindjes 23.1.1959, Vlorë.

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 460, datë 25.5.2022, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Veliko Memushaj, i biri i Nebi dhe i Fatime, i datëlindjes 2.5.1953, lindur në fshatin Brataj, Komuna Brataj, Vlorë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

**KORRIGJIM GABIMI MATERIAL**

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 339, datë 21.12.2022, "Për një ndryshim në vendimin e ERE-s, nr. 28, datë 14.2.2022, 'Mbi kërkesën e OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, 'Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, 'Mbi përcaktimin e Metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013"", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 12, datë 23.1.2023, f. 140 bëhet korrigjimi i gabimit në dispozitivin e këtij vendimi si vijon:

**Dispozitivi bëhet:**

1. Për disa ndryshime në vendimin nr. 28, datë 14 shkurt 2022, të Bordit të ERE-s, në lidhje me

përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme.

(Bashkëlidhur, metodologjia e vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme.)

2. Pika 4 e vendimit të ERE-s nr. 28, datë 14.2.2022, ndryshon dhe bëhet:

"Ndryshimet e parashikuara në pikën 2 i shtrijnë efektet juridike nga data 15.2.2022.".

3. Pika 5 e vendimit nr. 28/2022, shfuqizohet dhe pika 6 ndryshon dhe bëhet:

"6. Furnizuesit të cilët lëshojnë faturë me vlerë referuese të raportojnë në ERE periodikisht (çdo katër muaj) jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës së raportimit në lidhje me aplikimin e vlerave referuese dhe gjetjet respektive nga Furnizuesi nga përpunimi i të dhënave.".

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e përfshira dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

METODOLOGJIA E VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME

a) Në rastet kur Furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

b) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

c) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me matës të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.

ç) Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, Furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.

d) Konsumatorët që nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike do të faturohen me vlerë referuese 0 kWh.

dh) Konsumatorët që kanë lexim me matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj, do të faturohen me vlerë referuese bazuar në vlerën mesatare për muajt e matur të konsumit të energjisë elektrike.

**KORRIGJIM GABIMI MATERIAL**

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, "Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.9.2022, bëhet korrigjimi në pikën 9 të tij, si më poshtë vijon:

**Neni 9, pika 1.2, germa "b" ishte**:

"vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë, administratorin/administratorët e saj;".

**Neni 9, pika 1.2, germa "b" bëhet**:

"vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë, administratorin/ administratorët e saj;".

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 24
Datë: 2023/02/15 15:00:47
a8b6a965-37fa-4533-97f5-59ca19532632

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë